



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

PROCESVERBAL

Tiranë, më 05.07.2018, ora 11:30

Drejton mbledhjen:

Mimi Kodheli – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. “Projektligji “Për ratifikimin e memorandumit të qëllimit ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për instalimin dhe përdorimin e Sistemit për Krahësimin dhe Vlerësimin e Sigurt të Identifikimit Personal (PISCES)”

2. “Projektligji “Për ratifikimin e protokollit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Spanjës, për zbatimin e marrëveshjes, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Evropian, për ripranimin e personave me qëndrim të paautorizuar”

3. Çështje të tjera

Marrin pjesë:

Mimi Kodheli, Elona Hoxha, Eglantina Gjermani, Andrea Marto, Evis Kushi, Klajda Gjoshaj, Xhemal Qefalia, Edmond Panariti, Klotilda Bushka, Adnor Shameti, Tritan Shehu, Klevis Balliu, Vasilika Hysi, Ervin Bushati

Mungojnë:

Edi Paloka, Nard Ndoka, Rudina Hajdari,

Të ftuar:

Rovena Voda - Zëvendësministër i Brendshëm

Renata Balliu - Drejtorja e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator në Ministrinë e Brendshme

Ernest Dimashi - Drejtorja e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

Ylli Kumria - Drejtorja e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

Zyhdi Mema - Drejtorja e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

Mimi Kodheli – Sot kemi për diskutim dy projektligje:

1. “Projektligji “Për ratifikimin e memorandumit të qëllimit, ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për instalimin dhe përdorimin e Sistemit për Krahësimin dhe Vlerësimin e Sigurt të Identifikimit Personal (PISCES)”

2. “Projektligji “Për ratifikimin e protokollit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Spanjës, për zbatimin e marrëveshjes, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Evropian, për ripranimin e personave me qëndrim të paautorizuar”.

Urdhëroni, zonja Balliu!

Zëvendësministria është duke ardhur, ndërkohë, në Kushtetutë e kemi të shkruar që nuk i presim dot as zëvendësministrat, madje as ministrat, kur kemi caktuar datën dhe orën.

(Diskutim pa mikrofon)

...ka pak zëvendësministra që duhet të zëvendësohen. Këtu në parlament, ligjet janë të tjera.

(Diskutim pa mikrofon)

E dashur Renata, ne nuk kemi asgjë më tepër se çdo bashkëpunëtor juaji, njeri i thjeshtë që ju kontaktoni përditë, kështu që relaksohu dhe fol për dy nga çështjet, ose...

Tritam Shehu - Për procedurë e doja fjalën. Me gjithë defektin e madh të ministrisë, unë them t'i kalojmë...

(Diskutim pa mikrofon)

Renata Balliu – Po ia kaloj fjalën zotit Dimashi, i cili është drejtor i Teknologjisë dhe Informacionit në Policinë e Shtetit. Ai është më në brendësi të problemit dhe e ka ndjekur procedurën e miratimit të PAIS-is dhe mund t'ju sqarojë rreth saj në mënyrë më të përmbledhur.

(Diskutim pa mikrofon)

Mimi Kodheli - Urdhëroni!

Ernest Dimashi – Shtetet e Bashkuara të Amerikës, duke u përfaqësuar nga Ambasada Amerikane në Shqipëri, kanë propozuar që në 8 pika kufitare të instalohet sistemi PISCES, i cili është një sistem për menaxhimin e hyrjeve daljeve në pikat kufitare, ku mendohet që të shtohen disa elemente shtesë për pjesën e sigurisë, këtu flasim për të dhënat biometrike dhe për imazhet. Pra, domethënë fotografitë e personave në momentin që hyjnë ose dalin nga pikat e kalimit kufitar. Kjo është një marrëveshje qëllimi, domethënë këtu janë disa detaje, por, ndërkohë, janë ngritur grupe punë, të cilat po punojnë për të detajuar

funksionalitetin e programit në bazë të procedurave dhe akteve normative, të cilat funksionojnë sot për kalimin e njerëzve në kufi.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit!

Mimi Kodheli – Kalojmë te pika e dytë e rendit të ditës, te projektligji “Për ratifikimin e protokollit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Spanjës, për zbatimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Europian për ripranimin e personave me qëndrim të paautorizuar”.

Urdhëroni!

Ylli Kumria – Faleminderit!

Kjo marrëveshje është në kuadër të rekomandimeve të progresraportit të BE-së për implementimin e marrëveshjes Shqipëri Komuniteti Europian për ripranimin e personave. Është parë e domosdoshme që të bëhet një protokoll për implementimin e kësaj marrëveshjeje. Kështu që jemi në vazhde të implementimit të marrëveshjes Shqipëri–Komuniteti Europian nëpërmjet kontrolleve të zbatimit, sepse këto përcaktojnë autoritetet përkatëse të komunikimit, njëkohësisht edhe pikat e kalimit kufitar nga bëhen këto riatdhesime.

Fillimisht ka qenë projekti ynë, por një moment të caktuar u quajt kundërprojekt i palës spanjolle. Pra, në zanafillë ka qenë nisma jonë, pra kemi marrë nismë ne.

Mimi Kodheli – E rëndësishme është që ratifikohet si protokoll.

Ylli Kumria – Sigurisht që po.

Ne vazhdojmë komunikime të drejtpërdrejta më mire sesa nëpër kanalet që punojnë.

Tritan Shehu – Pastaj do të vazhdojnë të punojnë në vendetë veçanta apo...

Ylli Kumria – Në kuadër të kësaj marrëveshjeje, kemi protokoll me vendet e BE-së, sepse me të veçantat vazhdojmë. Të veçantat janë vendet e origjinës. Nuk e di nëse jeni në dijeni, por ne kemi iniciuar marrëveshje me Irakun, Marokun, Afganistanin dhe Iranin.

Andre Marto - Me këto të BE-së do të bëhet me të gjitha apo...

Ylli Kumria – Këto të BE-së bëjnë protokolle, ndërsa marrëveshja ekziston nga të dyja palët. Neni 19 i marrëveshjes parashikon protokollin me vendet e Bashkimit Europian. Deri tani kemi 13 të tilla.

Mimi Kodheli – Kalojmë në votimin për miratimin e projektligjit “Për ratifikimin e memorandumit të qëllimit ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për instalimin dhe përdorimin e Sistemit për Krahësimin

dhe Vlerësimin e Sigurt të Identifikimit Personal (PISCES)”. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Faleminderit!

Kalojmë në votimin për miratimin e projektligjit “Për ratifikimin e protokollit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Spanjës, për zbatimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Evropian, për ripranimin e personave me qëndrim të paautorizuar”. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Faleminderit kolegë dhe punë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA